



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1716 /2021
Data: 09.03.2021

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e dytë-II- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 16.02.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të kompanisë NPL Pastrimi), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë) Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti vjetor i punës së kryetarit të komunës për vitin 2020.
3. Raporti i menaxhimit dhe parandalimit të përhapjes së pandemisë covid 19 në komunën e Hanit të Elezit.
4. Propozim vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh për institucionin parashkollor, dhe SHFMU "Ilza Thaçi" Hani i Elezit.
5. Raporti financiar për vitin 2020.
6. Propozim vendim për bartjen e të hyrave të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
7. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
8. Plani i punës së këshillave lokale të Komunës së Hanit të Elezit.
9. Informatë mbi raportin financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2020 Npl "Pastrimi" Sh.a.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të cilat të cilat i kemi dërguar kemi edhe një material shtesë kërkesë për emërtimin e parkut memorial "Bllaca 99". Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti vjetor i punës së kryetarit të komunës për vitin 2020.
3. Raporti i menaxhimit dhe parandalimit të përhapjes së pandemisë covid 19 në komunën e Hanit të Elezit.
4. Propozim vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh për institucionin parashkollor , dhe SHFMU “Ilza Thaçi” Hani i Elezit .
5. Raporti financiar për vitin 2020.
6. Propozim vendim për bartjen e të hyrave të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
7. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
8. Plani i punës së këshillave lokale të Komunës së Hanit të Elezit.
9. Informatë mbi raportin financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2020 Npl “Pastrimi” Sh.a.
10. Kërkesë për emërtimin e parkut memorial “Bllaca 99”.
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti vjetor i punës së kryetarit të komunës për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- në këtë raport janë munduar të paraqitur aktivitet të cilat e kanë karakterizuar komunën gjatë viti 2020. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- kërkoj sqarim për vendimet të cilat janë për largim nga lista e pagave, a bëhet fjalë për ata të cilët ishin me kontratë në vepër . Kërkoj sqarim për llaptopët të cilët janë sjell nga Sedat Peker për shkak se në raport nuk janë paraqitur si donacion.

Mallzum Qajani thekson:- zyra për regjistrim të veturave kur është funksionalizuar është bërë me punëtorët e administratës komunale dhe ata punëtorë janë hequr nga lista e pagave të komunës dhe kanë shkuar me Ministri të Punëve të Brendshme.

Edon Curri thekson:- llaptopët e kanë një sistem që nuk mund të punohet këtu dhe duhet të i ndërrohet sistemi tjetër në mënyrë që me u përdorë dhe pastaj do të vendoset se kujt me ju dhënë për me i shfrytëzuar për punë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti i menaxhimit dhe parandalimit të përhapjes së pandemisë covid 19 në komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- raportin për menaxhimin e pandemisë kemi pasur dilema a të jetë pjesë e raportit apo të jetë pjesë e veçanet por në fund u dakordua që të jetë si raport i veçantë për arsye se është një dukuri që e ka përshkruar komunën e Hanit të Elezit dhe institucionet dhe mendojmë që duhet të jenë shënime se me cilat probleme janë ballafaquar qytetarët. Këto shënime do të jenë për të ardhmen që me parë se si është ballafaquar komuna e Hanit të Elezit me këtë çështje. Nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

Teuta Shkreta thekson:- në vitin 2020 ishin 30 000 vizita në QKMF që mendoj që ka qenë absurdja e gjitha kohërave. Është bërë një punë mjaft e suksesshme fal bashkëpunimit me kryetarin e komunës, drejtorinë për shëndetësi dhe gjithë stafit të QKMF-së i cili ka bërë një punë mjaft të madhe.

Sabedin Hasallari thekson:- nuk do të thotë që është absurditet pse kanë pasur vizita qytetarët në QKMF por më mirë do të ishte të thuhet që ka qenë diçka e jashtëzakonshme, ndërsa për punën të cilën e kanë bërë i kemi përgëzuar çdo herë.

Mehmet Ballazhi thekson:- a ka raste të tilla që identifikohen që janë pozitive dhe nuk i përmbahen rregullave.

Mallzum Qajani thekson:-i kemi dy lloje të testeve , testi serologjik dhe testi që bëhet nga instituti. Me testet serologjike kemi raste pozitive dhe është këshilluar individi dhe familja të kenë kujdes në sjelljet e tyre. Ndërsa ata të cilët e bëjnë testin prej institutit dhe që dalin pozitiv komuna lëshohet vendim për izolim për individin dhe për familjen. Sipas IKSHPK-së nuk ka ndonjë rast që është pozitiv dhe që nuk ju ka përmbajtur rregullave.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I MENAXHIMIT DHE PARANDALIMIT TË PËRHAPJES SË PANDEMISË COVID 19 NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh për institucionin parashkollor , dhe SHFMU “Ilza Thaçi” Hani i Elezit .

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- sipas udhëzimit administrativ kërkohet që komisioni ta formon kuvendi i komunës dhe me udhëzim përfshihet që të jetë një anëtarë nga drejtoria e arsimit, një anëtarë prej këshillit të prindërve dhe një përfaqësues nga Ministria e Arsimit. Nëse keni ndonjë vërejtje dhe sugjerim mund ta parashtroni. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë propozoj që ta zgjedh ekzekutivi i komunës e mos të dërgohet në kuvend.

Menduh Vlasi thekson:-këtë propozim do ta përcjelli në Ministri të Arsimit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTOR/ESH PËR INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR DHE SHFMU “ILAZ THAÇI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti financiar për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- shqetësim kam pasur te bartja e mjeteve nga vitet paraprake në vitet vijuese sepse të njëjtin shqetësim e kam përcjellë në çdo mbledhje të kuvendit të komunës kur ka pasur të bëjë me bartje të mjeteve. Duhet të jetë shqetësim për planifikim më të mirë të projekteve sepse del që nuk ka planifikim të mirë apo keq menaxhim.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI FINACIARË PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Propozim vendim për bartjen e të hyrave të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- në total të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2019 dhe 2020 janë në shumën prej 57,779.88 €, të cilat i bartim për vitin 2021. Këto mjete sipas pikës 2 (në shumë prej 57,779.88 €), i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon: mallra dhe shërbime në shumë prej 7,071.61 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 5,290.00 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 45,410.27 €. Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale në shumë prej 45,410.27 € në nën-programet dhe në projektet, si vijon Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve (18444), në projektin: “Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujës-jellësit”, kodi (47216) shuma prej 28,000.00 €. Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), në projektet: “Mjete të lira për bashkëinvestime”, kodi (41641) shuma prej 9,247.27 €, “Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në zonat urbane dhe rurale (49987) shuma prej 3,227.10 €. Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), në projektin: “Renovimi i objektit të QKMF-së”, kodi (49993) shuma prej 4,935.90 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- te shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujës-jellësit a është paraparë në mënyrë specifike se cila pjesë dhe cili rrjetë apo në mënyrë të përgjithshme. Ka shumë projekte të tjera që janë gati dy apo tri herë dhe përgjesohen në vende urbane dhe në vende rurale. Është mirë të përcaktohet çështja e rrjetit të ujës-jellësit në mënyrë që të dihet se në cilën pjesë është kryer në mënyrë që mos të merremi me atë pjesë në të ardhmen. Është mirë të përcaktohen projektet nëse është në Gorancë të shkruhet sepse kur po përgjesohen nuk po e dimë se cila pjesë është kryer dhe cila ka mbetur. Dhjetë vite i ka që është i njëjti raport i njëjti planifikim në vendet rurale dhe urbane nuk ka projeksione që specifikohen.

Sabedin Hasallari thekson:- mjetet të cilat janë bartur në kategorinë subvencione dhe transfere a ka mundësi që të kompensohen personat të cilët ishin të sëmurë me kovid. Unë edhe në vitin 2020 kam propozuar por është potencuar që nuk kemi mjete financiare. Të gjitha komunat e Kosovës i kanë subvencionuar me mjete financiare personat të cilët ishin të prekur me kovid-19 vetëm komuna jonë nuk i ka subvencionuar.

Mallzum Qajani thekson:- sa i përket bartjes së mjeteve financiare është një proces po thuaj se i pa shmangshëm. Komuna disa projekte i planifikon që do të realizohen përmes subvencioneve të ndryshme dhe në listën e prioritetëve dashtëm apo nuk dashtëm duhet të ketë projekte të planifikuara dhe ato projekte planifikohen përmes të hyrave vetanake dhe një pjesë e tyre mbesin të pashpenzuara. Pjesa e të hyrave vetanake që inkasohen në fund të vitit kalendarik edhe nëse duam me i shpenzuar nuk mundemi sepse nuk procedohen dhe duhet të barten. Projekti i ujësjellësit është një projekt që sillet përmes kompanisë së “Bifurkacionit”, CDI-së dhe komunës së Hanit të Elezit afër qe dhjetë vite. Projekti është në detal se çka do të bëhet, e ka bërë CDI-ja e cila do të i zhvillon të gjitha procedurat e tenderit. Është shpallur tenderi dhe ka dështuar. Do të bëhet rehabilitimi i fabrikës së ujësjellësit në tërësi, rirregullim i ujësjellësit mbi magjistrale dhe në disa segmente të tjera CDI-ja është zotuar se do ti jepër treqind mijë euro dhe komuna do ta financon pjesën tjetër. Potencuat për projektet e parcializuara, nëse komuna do të bënte një listë të projekteve do të na dale një gamë e listës së projekteve që për secilën duhet të zhvillohen procedura të veçanta dhe për mos me zhvilluar procedura të veçanta edhe për njëqind metra trotuar, apo për njëqind metra për një rrugë lokale ne i kemi potencua shtrim me kupëza betoni në zonat rurale dhe në zonat urbane. Hani i Elezit nuk ka ndonjë rrugë me ndonjë gjatësi që do të realizohet si projekt i veçantë dhe si projekte të përbashkëta është më funksionale për zhvillimin e procedurave të prokurimit sepse nëse bëhet si projekt për secilin duhet të zhvillohet procedurë e veçantë. Kjo ka kaluar në kuvend dhe është punë e kryer çështja e projekteve. Për çështje të subvencioneve nuk kemi pasur mjete për shkak se si komunë i kemi pasur testet serologjike dhe testet e IKSHPK-së dhe nëse ja nisim me ndarë nuk mund të ndalet deri sa të ketë koronavirus dhe komuna e ka shumë problematike për këtë punë.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse është punë e kryer nuk ka pasur nevojë me sjell. Te raporti i punës kur punohet diçka dihet, e këtu nuk po e dimë na se këto mjete financiare kanë me u bartur në projekte të ndryshme se s’mundemi me përcaktuar. Te raporti i punës mund të përcaktohen se ku janë shpenzuar e që rasti konkretë ishte për muret mbrojtëse është mirë të dihet se ku janë bërë ato mure mbrojtëse. Është mirë të dihet në detale për secilin projekt që kryhet për shkak se po përgjigjsohen.

Sabedin Hasallari thekson:- duhet të kompensohen personat të cilët e kanë bërë testin prej IKSHPK-së sepse në këtë formë e kanë aplikuar të gjitha komunat dhe komuna jonë ka përfitur nga rimëkëmbja ekonomike një vlerë të konsiderueshme prej buxhetit të Republikës së Kosovës dhe nuk ka qenë ndonjë vlerë e madhe për me i kompensuar personat të cilët ishin të prekur me kovid.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështja e shujtave a mund të hyjë te subvencionet apo te pagat dhe mëditjet dhe është mirë një pjesë te këtyre mjeteve financiare me dedikuar për çështje të shujtave.

Shabi Rexhallari thekson:- bartja nuk mund të bëhet diku që nuk ka qenë e planifikuar gjatë vitit 2020 dhe nëse kanë mbetur në kapitale duhet të shkojnë në kapitale, një pjesë duhet të shkon në subvencione, një pjesë duhet të shkon te mallrat dhe shërbimet, ndërsa në paga nuk kemi pasur të planifikuara dhe nuk mund ti dedikojmë në paga. Në fondin rezervë në fillim ishin 168 000 € dhe 22 000 € me rishikim buxhetit Ministria i ka dedikuar në pagat e shëndetësisë me i mbuluar një pjesë. Me rishikim të buxhetit një pjesën e kemi bartur në kapitale dhe një pjesë tjetër në mallra dhe shërbime. Një pjesë kemi mundur me bartë në mallra dhe shërbime me kështu që arsimtarët me shkuar përmes gjykatës, ndërsa ndryshe nuk kemi mundur. Në muajin dhjetorë kemi bërë përpjekje por nuk u krye, përsëri në janar kemi provuar por nuk është kryer dhe tash për shkurt i kemi dërguar por nuk kemi marr përgjigje ende. Duhet të shikojmë se si do të veprojnë nivelet tjera dhe rrugëdalje tjetër nuk ka përveç se me anë të gjykatës.

Mehmet Ballazhi thekson:- është mirë që DKA-ja me përcjellë te arsimtarët dhe profesorët që nuk ka mundësi me u kryer dhe tu shpjegohet që të merren iniciativa prej mësimeve në mënyrë të organizuar me proceduar në gjykatë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR BARTJEN E TË HYRAVE TË PASHPENZUARA NGA VITI I KALUAR NË VITIN AKTUAL QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- kuvendi i komunës për vitin 2020 ka planifikuar t'i mbajë dymbëdhjetë mbledhje, ndërsa i ka mbajtur vetëm dhjetë mbledhje të rregullta për arsye të pandemisë. Për shkak të pandemisë i ka mbajtur dy mbledhje të jashtëzakonshme. Për rishqyrtim është kthyer rregullorja për taksa komunale për vitin 2021. Në vitin 2020 janë miratuar 37 vendime dhe pesë rregullore. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Plani i punës së këshillave lokale të Komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- këshillat e fshatrave duhet të ristrukturohen sipas rregullores dhe me që pandemia ishte prezent gjatë viti 2020 nuk ka mundur të bëhet. Administrata komunale ka bërë një plan në bashkëpunim me administratorët e fshatrave dhe i ka paraparë aktivitetet që do të zhvillohen për vitin 2021. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I KËSHILLAVE LOKALE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Informatë mbi raportin financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2020 Npl "Pastrimi" Sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kujtim Dernjani thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Mehmet Ballazhi thekson:- është mirë që të vetëdijesohen qytetarët që mos mi qit te dera në mbrëmje kontinierët sepse qenët po i bëjnë tollovi.

Teuta Shkreta thekson:- si qytetarë jemi të kënaqur për shërbimet që i kryen kompania. Sa është e kënaqur kompania me pagesat që i kryejnë qytetarët.

Kujtim Dernjani thekson:-nëse analizohet me përqindje inkasimi është 99%.

Sabedin Hasallari thekson:- kërkoj nga kompania që t'i ulë shpenzimet edhe pse ka rritje të të hyrave dhe po ashtu është mirë që të gjejnë forma që me ulur borxhin që e kanë qytetarët ndaj kompanisë. Kërkoj që të paguhet komisioni i aksionarëve i NPL "Pastrimi" Sh.a.

Kryesuesi thekson:- duhet të shikojmë se a lejohet me ligj në mënyrë që mos me bërë shkelje ligjore. Në tabelar duhet të jetë bartje se ju e keni paraparë fitim edhe humbje. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN FINACIARË PËR PERIUDHËN JANARË –DHJETORË 2020 NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

10. Kërkesë për emërtimin e parkut memorial "Bllaca 99".

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- ju e dini që memoriali "Bllaca 99" ka filluar të bëhet qysh në vitin 2019 që ishte njëzet vjetori. Bartës të investimeve ka qenë përmes shoqatës për kthimin e shqiptarëve, i trashëgimisë kulturore në Maqedoni. Ata ju kanë drejtuar komunës së Hanit të Elezit që si pjesë e memorialit është edhe parku dhe në këtë vit është njëqind vjetori kur "Hasan Prishtina" ka qenë kryeministër i shtetit shqiptarë ata kanë kërkuar që pjesa e parkut dhe ajo pjesa e cila është me pisha të emërtohet me emrin "Hasan Prishtina".

Mehmet Ballazhi thekson:- realisht është kompleks për shkak se është treni, memoriali dhe personalisht nuk mu dukë e arsyeshme me ndonjë emërim shtesë "Hasan Prishti" apo kushdo që të jetë , jo për një zhvlerësim por ajo është memorial apo kompleks "Bllaca 99" që përfshinë me "Hansan Prishtina" apo me të gjitha figurat eminente e jo vetëm me lënë një emër për me ja bërë qefin. Çka mundemi me rritë "Hasan Prishtinën" nëse ja lajmë emrin, unë nuk e kam parë të arsyeshme për shkak se është "Bllaca 99" dhe kuptohet se për çka është.

Mallzum Qajani thekson:- nuk është iniciativë e komunës por ata kanë investuar edhe për trenin, edhe për murin e kujtesës, edhe pishat të cilat i kanë mbjellur dhe e kanë parashtruar këtë kërkesë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.


U VOTUA KËRKESA PËR EMËRTIMIN E PARKUT MEMORIAL "BLLACA 99" QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

11. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

